VENDIM
Nr.1027, datë 9.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.412, DATË 15.9.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM, PËR DHËNIEN E LICENCAVE PROFESIONALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i fundit, i pikës 1 të vendimit nr.412, datë 15.9.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha